

**Bashkia:** PUSTEC

**Kryetar:** EDMOND THEMELKO

**Fusha:** INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

**Premtime:**

1. Do të ndërhyet në kanalizimin e ujërave të zeza në territorin e bashkisë
2. Do të punohet dhe aplikohet për digjitalizimin e infrastrukturës së rrugëve dhe shesheve me adresat dhe emërtimet e reja
3. Do të zgjidhet problemi i ujit të pijshëm për 7 fshatra të zonës
4. Do të merret një mjet fadromë, i cili nevojitet për të përballuar nevojat e bashkisë për punimet në infrastrukturën rrugore, si dhe në mirëmbajtjen e lumenjve dhe të kanaleve kulluese dhe vaditëse në zonën e Prespës
5. Do të ndërtohet dhe sistemohet qendra e fshatit Pustec, e cila njëkohësisht është edhe qendra e bashkisë

**Fusha:** ARSIM/KULTURË/SPORT

**Premtime:**

**Fusha:** MJEDIS/TURIZËM

**Premtime:**

1. Do të vihet në përdorim motobarka me energji diellore “Green Boat”, e cila do t’i japë mundësi turistëve të bëjnë shëtitje nëpër ujërat e Liqenit të Prespës
2. Do të punohet në drejtim të zhvillimit të turizmit familjar, të turizmit liqenor dhe kulturor, si degë kryesore të mundshme për t’u zhvilluar
3. Do të përkrahen dhe ndihmohen të gjitha familjet në zonë të cilat shfaqin interesin për zhvillimin e turizmit familjar, gjithashtu bashkia, në bashkëpunim edhe me drejtuesit e Parkut të Prespës dhe me shoqatat që veprojnë në zonë do të krijojnë ekspozime të mundshme të zhvillimit të turizmit duke reklamuar dhe ndihmuar ndërtimet e kapaciteteve të reja turistike, si dhe duke reklamuar prodhimet bujqësore dhe blegtorale
4. Do të ndërtohen dy pika grumbullimi të mbetjeve urbane. Në këto dy pika do të grumbullohen të gjitha mbetjet e zonës duke i grumbulluar dhe transportuar në destinacion nga punonjësit dhe nga dy mjete transporti

**Fusha:** BUJQËSI

**Premtime:**

1. Do të organizohen forma pune dhe propagandime nga specialistet e bashkisë, specialistë të parkut të Prespës, si dhe të organizatave dhe shoqatave të ndryshme që veprojnë në fushën e bujqësisë, veçanërisht në drejtim të kultivimit të çajit të malit, të grumbullimit të

- bimëve mjekësore, në rritjen e prodhimeve bujqësore si dhe në rritjen e numrit të koshereve të bletëve, të numrit të krerëve të bagëtive të imta e të trasha, etj
2. Do të bëhet propagandim i aplikimit për kredi nga shteti në drejtim të rritjes së numrit të krerëve në blegtori
  3. Do të hapen punishte dhe përpunohen prodhime bujqësore dhe blegtorale në zonë, si pika për grumbullimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, punishte për përpunimin e fruta-perimeve dhe për përpunimin e qumështit
  4. Do të punohet për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë dhe blegtorisë në zonë, me qëllim që të arrihet në kapacitetet e dikurshme, duke pasur parasysh se bujqësia dhe blegtoria në zonë janë hallkat kryesore të ekzistencës dhe të zhvillimit të jetës
  5. Do të stimulohen të gjithë fermerët që merren me rritjen e bletëve

**Fusha: TRANSPARENCA**

**Premtime:**

1. Do të zhvillohen takime dhe konsultime me banorët e zonës për problemet kryesore që shqetësojnë popullsinë, si dhe parashikimin e mënyrave për zgjidhjen e tyre
2. Do të organizohen takime dhe konsultime të veçanta, me banorë të fshatrave të cilëve u përket problemi, si dhe me grupe banorësh në sferën e arsimit, të fesë, të kulturës, të shëndetësisë, etj

**Fusha: SHËRBIMET SOCIALE**

**Premtime:**

**Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM**

**Premtime:**

1. Do të sigurohet punësimi i vajzave dhe grave në një fasoneri të hapur në territorin e bashkisë
2. Me hartimin e Master Planit do të parashikohet një hapësirë e lirë për investitorët në mënyrë hapjen e vendeve të reja të punës